



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	20/DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. I faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-4019/15
Br. Prot.	
Prot No	
Data	09-11-2015
Datum	
Date	
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës

### Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 06.11.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylllet rasti me Nr. AKK-03-02-2951-15 për z.Armend Ibrahimimi–Këshilltar politik në Zyren e Kryeministrit të Kosovës (ZKM), për shkak se ështëshmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Ibrahimini ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në një biznes privat.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2951-15, për Zyrtarin e lartë, z.Armend Ibrahimimi–Këshilltar politik në Zyrën e Kryeministrit (ZKM), dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z. Ibrahimimi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit, pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Ibrahimimi, është deklaruar se do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjell një shkresë përcjellëse bashkë me shkresën zyrtare (DPK/DPKI-03-02-3902/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se te biznesi; Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "Adam" sh.p.k., tashmë, z. Ibrahimimi është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

